

INTERVISTË PËR EMISIONIN “PYET AVOKATIN”



Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore, znj. Patricia Pogaçe, së bashku me disa specialistë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ndanë informacion dhe iu përgjigjën pyetjeve mbi Ndihmën Juridike Falas në emisionin “Pyet Avokatin”.

INTERVISTË E DREJTORESHËS SË MBIKËQYRJES SË STANDARTEVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Znj. Klejda Poçi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Dytësore dha një intervistë për RTSH Kukësi. Gjatë intervistës znj. Poçi theksoi rëndësinë e shërbimeve ligjore falas,



TRYEZË VLERËSUESE MBI PROJEKTIN “SHËRBIME TË PËRMIRËSUARA TË NDIHMËS LIGJORE”

U zhvillua tryeza vlerësuese e projektit të ri “Shërbime të përmirësuara të ndihmës ligjore (EQUALS)”, i cili do të implementohet nga UNDP Albania dhe Ministria e Drejtësisë/ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas me mbështetjen e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).



TRYEZË NDËRINSTITUCIONALE

U zhvillua në Durrës, në bashkëpunim me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe QSHNJP Kavajë e Durrës, tryeza ndërinstitutionale me përfaqësues të institucioneve në nivel vendor, organizatave të shoqërisë civile, avokatëve dhe ndërmjetësve.




MBËSHTETJA E AKSESIT TË QYTETARËVE NË DREJTËSI NËPËRMJET NDËRMJETËSIMIT NË SHQIPËRI

Drejtoresha e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standarteve dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Dytësore ishte pjesë e takimit të organizuar në kuadër të projektit “Mbështetja e aksesit të qytetarëve nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri”.



FIRMOSET MARRËVESHJA MES BASHKISË KAMËZ DHE DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Aktivitetet e ndjekura në bashkëpunim me OSBE u konkretizuan me lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Bashkisë Kamëz.



TAKIM ME PËRFAQËSUES TË ORGANIZATËS “DREJTËSI SOCIALE”

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi një takim me përfaqësues të organizatës “Drejtësi Sociale”. Gjatë takimit u diskutuan sfidat ekzistuese dhe mënyrat për të përmirësuar ofrimin e ndihmës ligjore falas për qytetarët në nevojë.

PREZANTIMI I PROJEKTEVE MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT “EPOKA”

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ishte e ftuar pranë universitetit “Epoka”, në prezantimin e punimeve të studentëve të fakultetit të drejtësisë të cilët kanë kryer praktikën pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.



TAKIM ME PËRFAQËSUES TË UNHCR ALBANIA

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi një takim me përfaqësues të UNHCR Albania në kuadër të projektit EU4Migration.

TAKIM NË KUADËR TË FORCIMIT TË BASHKËPUNIMIT SHQIPËRI - KOSOVË

Drejtoresha e Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Dytësore, znj. Klejda Poçi, zhvilloi një vizitë zyrtare pranë Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas në Kosovë, ku u prit nga z. Faton Jashari, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas.



AKTIVITETE TË ZHVILLUARA NGA QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

QSHNJP Elbasan zhvilloi një aktivitet informues mbi ndihmën juridike falas në kuadër të 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

QSHNJP Elbasan zhvilloi një aktivitet Street Law në kuadër të 19 Qershorit, Ditës së Eleminimit të Dhunës Seksuale në Konflikt. Aktiviteti synonte informimin e qytetarëve mbi Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

QSHNJP Elbasan, zhvilloi një aktivitet Street Law në datën 26.06.2025 në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit.

QSHNJP Elbasan, në kuadër të aktiviteteve në bashkitë e vogla, zhvilloi një takim me përfaqësues të Bashkisë Gramsh lidhur me Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

QSHNJP Dibër në datën 23.06.2025 mori zhvilloi një aktivitet Street Law në qytetin e Peshkopisë në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit.



QSHNJP Mat në datën 01.06.2025 mori pjesë në një aktivitet të zhvilluar me prezencën e të miturve dhe familjarëve të tyre. Gjatë kësaj aktiviteti u informuan të pranishmit mbi shërbimin ligjor falas.



QSHNJP Mat në datën 19.06.2025 zhvilloi një takim me fokus prezantimin e ndihmës juridike falas të të miturit pranë Kishës Ungjillore, dega Mat.

QSHNJP Mat në datën 23.06.2025 mori pjesë në takimin e Grupit Teknik Ndërsektorial në Bashkinë Mat ku u diskutua mbi dhunën në marrëdhëniet familjare.



QSHNJP Mat në datën 24.06.2025, në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit, zhvilloi një aktivitet Street Law për të informuar pjesëtarët e këtij komuniteti mbi shërbimin e ndihmës juridike falas.

QSHNJP Lushnje mori pjesë në një aktivitet në kuadër të 1 Qershorit ku promovoi shërbimet e Qendrës dhe Ligjin Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".



QSHNJP Lushnje në datën 18.06.2025 zhvilloi një takim në kuadër të viktimave të trafikimit. Aktiviteti konsistoi në shpërndarjen e fletëpalosjeve informuese.



QSHNJP Lushnje në datën 13.06.2025 ishte pjesë e takimit të organizuar nga Shërbimi Social, Bashkia Lushnje, me temë "Shërbimet sociale të integruara për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të komuniteteve në nevojë".

QSHNJP Lushnje në datën 23.06.2025, në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit, zhvilloi një takim promovues mbi ndihmën juridike falas me pjesëtarë të këtij komuniteti.



QSHNJP Lushnje në datën 26.06.2025 zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogërave.



QSHNJP Lushnje ishte pjesë e një takimi të zhvilluar nga Bashkia Lushnje dhe Qendra "Askush të mos mbetet pas" ku u diskutua mbi bashkëpunimin ndërinstitucional.

QSHNJP Korçë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve realizoi një aktivitet informues me fokus në ofrimin e informacionit mbi ndihmën juridike dhe të drejtat e fëmijëve.



QSHNJP Korçë, në bashkëpunim me Misionin Emanuel, zhvilloi një aktivitet në qendrën ditore për fëmijë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm, Viktima të Agresionit.



QSHNJP Korçë realizoi në datën 10.06.2025 një takim me përfaqësuesin e UNHCR, në qytetin e Korçës Z. Astrit Brasha, ku u diskutua mbi shërbimin ligjor falas..



QSHNJP Korçë në datën 13.06.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law për të informuar qytetarët lidhur me Ligjin Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

QSHNJP Korçë mori pjesë në aktivitetin "Massive Outdoor Event", në kuadër të projektit "Perspektiva që mundësojnë punësimin e të rinjve - YEEP II".

QSHNJP Korçë në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit zhvilloi një aktivitet Street Law ku informoi qytetarët mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore.



QSHNJP Korçë në datën 24.06.2025, në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit, mori pjesë në takimin e realizuar nga Bashkia Korçë me përfaqësues të institucioneve lokale dhe përfaqësues të komunitetit egjiptian



QSHNJP Durrës zhvilloi në datën 03.06.2025, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm, Viktima të Agresionit.

QSHNJP Durrës datë 25.06.2025 në kuadër të Promovimit të Ndhmës Juridike Falas dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve organizoi një aktivitet në ambientet e Shërbimit Social, duke bërë të mundur vendosjen e bashkëpunimit mbi referimin e rasteve.



QSHNJP Durrës dhe **QSHNJP Kavajë** në datën 27.06.2025 zhvilluan një takim me kryetaren e Njesisë Administrative Manëz ku u diskutua mbi promovimin e ndihmës juridike falas.

QSHNJP Durrës dhe **QSHNJP Kavajë** në datën 27.06.2025, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave, zhvilluan një aktivitet Street Law.



QSHNJP Kavajë ishte e ftuar në takimin e GNT, të organizuar nga Shërbimi Social Social Kavajë me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe diskutimin mbi raste konkrete.

QSHNJP Fier zhvilloi një takim me Njësine e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Bashkisë Fier, në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm, Viktima të Agresionit" - një ditë reflektimi, por edhe thirrje për veprim.



QSHNJP Fier ishte pjesë e aktivitetit të zhvilluar nga FSHDPAK në bashkëpunim me UN Women, mbi mbrojtjen e të drejtave të grave.



QSHNJP Fier në kuadër të Ditës Botërore të Abuzimit Kundër të Moshuarve zhvilloi një takim informues me të moshuarit pranë ambjenteve të Qendrës Social Komunitare Roskovec. Qëllimi i aktivitetit ishte ndërgjegjësimi mbi të drejtat e të moshuarve, format e abuzimit që ata mund të përjetojnë, si dhe mundësitë që ofron Ndihma Juridike Falas për mbrojtjen e këtyre të drejtave.



QSHNJP Fier zhvilloi një takim pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier, në kuadër të "Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt".



QSHNJP Fier, në kuadër të Ditës së Komunitetit Egjiptian, zhvilloi një takim informues me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Këshillit të Europës, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përfaqësues i Komunitetit Rom i cili është mbështetës edhe për komunitetin Egjiptian.



QSHNJP Fier në datën 27.06.2025 zhvilloi një takim informues pranë Njesisë Administrative Portëz, në kuadër të misionit për informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre ligjore, si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".



QSHNJP Fier në datën 27.06.2025 zhvilloi një takim pranë Bashkisë Patos me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe përmirësimit të mekanizmave të referimit të rasteve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas





QSHNJP Tropojë zhvilloi më datë 11.06.2025 një takim me Administratorin e Njësisë Administrative Fierzë z. Shkëlqim Dushaj, specialistë pranë këtij institucioni dhe qytetarë, ku u diskutua mbi Ligjin Nr. 111/ 2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

QSHNJP Tropojë në kuadër të bashkëpunimit mes Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në Shqipëri dhe Agjencisë Për Ndhmë Juridike Falas në Kosovë , u zhvillua një takim prnë Zyrës Rajonale për Ndhmë Juridike Gjakovë.



QSHNJP Tropojë organizoi në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm, Viktima të Agresionit, zhvilloi një takim me punonjës të Shërbimit Social pranë Bashkisë Tropojë.

QSHNJP Tropojë në datën 13.06.2025 zhvilloi një takim me Kancelarin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Gjatë takimit u diskutua mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me kërkesat për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, trajtimin e tyre brenda afati ligjor të përcaktuar si një kriter i rëndësishëm i aksesit të qytetarëve në drejtësi.



QSHNJP Tropojë në datën 18.06.2025 një takim me institucionet kryesore që veprojnë në Bashkinë Tropojë. Qëllimi i takimit ishte rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional me fokus aksesin në drejtësi të të gjithë subjekteve përfituese të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Vlorë zhvilloi një takim me Drejtuesen e Drejtorisë Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Vlorë, me fokus çështjen e njohjes së pensioneve për shtetasit shqiptarë që kanë punuar dhe kontribuar në Itali.

QSHNJP Vlorë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm, Viktima të Agresionit organizoi një aktivitet me fëmijët e familjeve që aktivizohen pranë Qendrës së Shërbimeve Mbështetëse, pjesë e Drejtorisë së Shërbimit Social Vlorë.



QSHNJP Vlorë mori pjesë në Forumin e organizuar nga Qendra Burimore për Shoqërinë Civile / ACPD, në bashkëpunim me Qendrën për Hapje dhe Dialog – COD dhe Qendrën Rinore Vlorë.

QSHNJP Vlorë në datën 23.06.2025 mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Kartës Europiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.



QSHNJP Vlorë në datën 24.06.2025 ishte pjesë e një takimi në Ditën Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit, me ftesë të Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Vlorë, në praninë e Ekspertes së Çështjeve të Pakicave Kombëtare, znj. Eralda Çani dhe Këshilltarit të Kabinetit të Bashkisë Vlorë për Pakicat, z. Azem Haliti.



QSHNJP Vlorë në datën 26.06.2025 zhvilloi një takim në Bashkinë Himarë në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve promovuese mbi Ndhmën Juridike Falas në bashkitë e vogla.

QSHNJP Shkodër zhvilloi një aktivitet Street Law në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.





QSHNJP Shkodër zhvilloi një takim informues lidhur me përfitimën e ndihmës juridike parësore dhe dytësore me përfaqësues të OJF "Drejtësi Sociale".

QSHNJP Shkodër zhvilloi një takim informues me përfaqësuesen e zyrës vendore rajonale të Avokatit të Popullit znj. Abeta Bajraktari dhe përfaqësuesin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi z.Dejan Cullafiq.



QSHNJP Shkodër në datën 17.06.2025 mori pjesë në Tryezën Teknike Ndërinstitucionale në vijim të zbatimit të projektit: "Krenar që kemi të drejta: Promovimi i barazisë, përfshirjes sociale dhe mosdiskriminimit të grave dhe personave LGBTIQ+ në Shqipëri".

QSHNJP Shkodër në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit organizoi një takim me përfaqësues të këtij komuniteti.



QSHNJP Kurbin realizoi një takim me përfaqësuesin e personave me aftësi të kufizuara në qytetin e Kurbinit, z. Pjetër Llesh Zima, ku u diskutua rëndësia e ndihmës juridike falas për këtë kategori të veçantë.

QSHNJP Kurbin në datën 20.06.2025 ka organizuar një takim informues mbi ndihmën juridike falas në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit.

QSHNJP Kurbin në datën 23.06.2025 ka zhvilluar një takim informues me disa të rinj në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogërave.



QSHNJP Lezhë ishte e ftuar në workshopin e orgnizuar nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social në bashkëpunim me qendrën "Strehëza Edlira Haxhiymeri" lidhur me "Qasjen Ndërsektoriale dhe Përmirësimin e Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje".



QSHNJP Lezhë në datën 24.06.2025 në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit zhvilloi një aktivitet Street Law në zonën ku ky komunitet është i vendosur.

QSHNJP Lezhë në datën 26.06.2025 në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Abuzimit dhe Trafikimit të Drogërave mori pjesë në takimin e organizuar nga NJVKSH me synim informimin e të miturve.



QSHNJP Pogradec në datën 19.06.2025 organizoi një takim me përfaqësues të Shërbimit Social, Bashkia Pogradec, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Eliminimit të Dhunës Seksuale në Konflikt.

QSHNJP Pogradec, në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Përfshirjes Sociale, Barazisë Gjinore dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, i cili organizoi një aktivitet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve lokale dhe qëndrore.



QSHNJP Tiranë zhvilloi një aktivitet Street Law, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt.



QSHNJP Tiranë në datën 04.06.2025 ishte pjesë e një tryeze diskutimi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, psikologëve, juristëve të QSHNJP, dhe qytetarëve, ku u prezantuan raste konkrete dhe legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të miturve, si dhe u theksua rëndësia e raportimit dhe aksesit në drejtësi për këtë kategori të ndjeshme.



QSHNJP Tiranë është angazhuar me afishimin e posterave të rinj informues mbi ndihmën juridike falas, në institucionet më kryesore të vendit.

QSHNJP Berat në datën 26.06.2025 ishte pjesë e një takimi të organizuar në bashkëpunim me Qendrën “Vatra” dhe Bashkinë Berat, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në Mbështetje të Viktimave të Torturës.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 01.06.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 17.06.2025 mori pjesë në një trajnim në kuadër të projektit: “Fuqizimi i Kapaciteteve të Qendrës Sociale Komunitare ‘Zinxhira’ për të Ofruar Shërbime të Specializuara dhe gjithpërfshirëse për Komunitetet në Nevojë në Gjirokastrë”

QSHNJP Gjirokastrë dhe QSHNJP Përmet në datën 11.06.2025 zhvilloi pranë Bashkisë Këlcyrë një takim në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt.

QSHNJP Gjirokastrë dhe QSHNJP Përmet në datën 11.06.2025 zhvilloi dy aktivitete Street Law në qytetin e Tepelenës dhe në Memaliaj.

QSHNJP Gjirokastrë dhe QSHNJP Përmet organizoi një aktivitet Street Law në kuadër të Ditës së Egjiptianëve të Ballkanit.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 23.06.2025 ishte e ftuar në aktivitetin e organizuar nga UNFPA dhe Nesmark me temë: “Abuzimi seksual i fëmijëve”.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 27.06.2025 ishte pjesë e aktivitetit të zhvilluar nga kryetarja e PAK Gjirokastrë, me pjesëmarrjen e presidentit të shoqatës së invalidëve z. Abdulla Omuri, për të diskutuar mbi problematikat e kësaj kategorie të veçantë.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 02.06.2025 ishte e ftuar nga Qendra e Dhunës dhe Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Gjirokastrë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm, Viktima të Agresionit.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 24.06.2025 mori pjesë në fazën e dytë të trajnimit: Fuqizimi i Kapaciteteve të Qendrës Sociale Komunitare ‘Zinxhira’ për të Ofruar Shërbime të Specializuara dhe gjithpërfshirëse për Komunitetet në Nevojë në Gjirokastrë”

